

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SOMA" SHPK

Sot me daten 13/01/2023 (dymijë e njëzet e TRE), unë ortaku themelues :

- **I Z. Kelly Mc Cune Crawford**, shtetas amerikan, i datëlindjes 01 Gusht 1970, lindur në California dhe banues në Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (pasaportë) me Nr. 669866184

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "SOMA" SHPK.*

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet "SOMA" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Rruga BLV.ZOGU 1, godina 13, Zona Kadastrale 8350, nr. pasurie 6/470+1-1, Tiranë.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje kompani me pergjegjesi te kufizuar mund te kryeje ne perputhje me legjislacionin shqiptar, brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, perfshire por pa u kufizuar ne: Agroturizëm; Ndermarrje Bujqesore për shfrytëzimin e tokës dhe ujit duke ushtruar dhe promovuar peshkimin çlodhës, peshkimin amator të kohës së lirë, kultivimin, mbledhjen dhe tregtimin e peshkut në basene ujore natyrale ose të krijuara duke shfrytëzuar racionalisht dhe duke ruajtur diversitetin biologjik dhe minimalizuar ndikimet në ekosistemin ujor për të ruajtur/promovuar zinxhirin ushqimor. Agroturizem, stukturë akomoduese, veprimtari pritese, mbarështrimin e peshkut, blegtorisë, shpendëve, pemëve frutore dhe dekorative. Rritjen e aksesit, qëndrueshmërisë, aftësive dhe përdorimit të TIK-ut, rritjen e bazës së njohurive socioekonomike të sektorit duke promovuar zonën si një destinacion unik për përfshirja e turizmit në vend. Zhvillimi i bletarise, shtimi dhe mbarështrimi I tyre. Organizimi i guidave turistike. Aktivitet ne Agroturizem dhe turizem rural. Akomodimi dhe ofrim ushqimesh dhe pije. Aktivitete dhe sherbime per argetim, shplodhje, turizem te natyres.



Import – Export: te rasat peshku, farerave, fidaneve, bimeve, gjetheve, shpendeve, makinerive te perpunimit bujqesor, ushqimor, blektoral, shpendeve, bimeve mjeksore, ushqime peshku, Nutrients per perime, peme frutore, Produkte amballazhimi per prodhime bujqësore, blektorale dhe peshkimi. Blerje-shitje të produkteve e nënprodukteve bujqësore, blegtorale, frutikulturë (pemtarie), shpendeve dhe te bimeve medicinale. Bar Restorant.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "SOMA" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

1. Kelly Mc Cune Crawford zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.

NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administratori i shoqërisë do të jetë Znj. Jona Sulejmani e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".



2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8
NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.


Neni 9
LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranë për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
" SOMA " SH.P.K
Kelly Mc Cune Crawford



Kelly Mc Cune Crawford